



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2019:131610

Datë: 11.04.2024

Numri i dokumentit: 05560192

**P.nr.152/2023**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË LIPJAN- Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal**, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm gjykues Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Rukije Matoshi, duke vendosur në çështjen penale, ndaj të pandehurit L. M. nga P., të cilin e ka akuzuar Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP.I.nr.233/2014 të datës 19.06.2014 për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe duke u kujdesur lidhur me parashkrimin e ndjekjes penale, jashtë seancës, me datën 11.04.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**I.HUDHET** aktakuza e PTH-Prishtinë, PP.I.nr.233/2014 të datës 19.06.2014

**II.PUSHOHET** procedura penale ndaj të pandehurit **L. M.**, i lindur me datën ... në fsh. S. i E. – P., nga i ati S. dhe e ëma N. Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, për shkak se ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, pasi që ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

**III.** Urdhërohet konfiskimi i përhershëm i sendit-armës elektrohok me ngjyrë të zezë të tipit, ....., nr.... W dhe dhe Detyrohet Policia e Kosovës – Stacioni Policor në Prishtinë, që arma e konfiskuar nëse është e vjetruar apo e dëmtuar ta shkatërroj – asgjësoj ose në të kundërtën nëse është funksionale dhe e nevojshme për Policin e Kosovës të kalohet tek Ministria e Punëve të Brendshme-Policisë së Kosovës.

**IV.** Shpenzimet e procedurës penale mbesin barrë e mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë, ka paraqitur aktakuzën PP.I.nr.233/2014 të datës 19.06.2014, kundër të pandehurit L. M. për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Gjyqtari i vetëm gjykues me rastin e shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, konstatoi se në rastin konkret sa i përket të pandehurit L. M. , ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale andaj edhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga shkresat e lëndës shihet se vepra penale për të cilën akuzohet i pandehuri është kryer me datën 12.02.2014 dhe parashkrimi i ndjekjes penale për veprën penale për të cilën akuzohet i pandehuri, sipas dispozitës të nenit 106 par. 1 pika 4 të KPRK-së, është 5 vite, ndërsa sipas

dispozitës së nenit 107 par. 8 të KPRK-së, është kur te ket kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale).

Pra, në rastin konkret i pandehuri akuzohet për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar i armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, për të cilën parashihet dënimi me gjobë apo me burgim deri në 5 vite andaj bazuar ne dispozitën e lartcekur parashkrimi absolut i ndjekjes penale në rastin konkret është 10 vite, dhe meqenëse nga data e kryerjes së veprës penale 12.02.2014, e gjer më tani kanë kaluar më shumë se 10 vite, nga këto arsye gjykata e hudhi aktakuzën e prokurorisë dhe e pushoi procedurën penale.

Vendimi lidhur me kompensimin e shpenzimeve procedurale dhe paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 454 par. 1 të KPPK-së ndërsa vendimi për konfiskimin e sendit u bazua në nenin 374 par.3 të KPRK-së.

Nga këto arsye gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- DEGA NË LIPJAN,**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal**  
**P.nr.152/2023 me data 11.04.2024.**

**Gjyqtari**  
**Avdirrahman Gashi**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 3 (tre) dite nga dita e pranimit të këtij aktvendimi. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmes kësaj gjykate.